

V E N D I M
Nr.333, datë 29.5.2003

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3) e lidhjes nr.1 është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka fituar.
 3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5, 6) të lidhjes nr.1 jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Shtetit.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.
 5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik” nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.
 6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.9.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Niveli i pagës bazë për gradë, sipas roleve për punonjësit e Policisë së Shtetit

Lidhje 1

Roli	Grada	Paga bazë(për gradë)	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
			Në funksione të policisë	Në funksione operuese N.shpejtë	Në funksione operuese F.speciale
1	2	3	4	5	6
Bazë	Agjent	24800	4000	7000	30000
	Agjent i I-rë	25800	4000	7000	35000
	Asistent	26800	4000	8000	42000
	Asistent i I-rë	27800	4000	8000	44000
	Kryeasistent	28800	4000	8000	44000
I Mesëm	Nëninspektor	37000	4000	6000	38000
	Inspektor	39000	4000	6000	38000
	Kryeinspektor	44000	4000	6000	38000
I Lartë	Nënkomisar	54000	4000	6000	31000
	Komisar	67000	4000	6000	31000
	Kryekomisar	77000	4000	6000	31000
Madhor	Drejtues	87000	8000	10000	
	Zv/Drejt.Përgjithshëm	103000	15000		
	Drejtor i Përgjithshëm	124500	20000		